

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Gjyqtar Altin Abdiu

asistuar nga sekretare gjyqësore Marjana Xhamallati, date 08.05.2013, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çështjen penale që u përket,

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Adnand Xhelili.

I pandehur: Xherxh Laçi, i biri i Nazif dhe i Shahe, i dtl.31.01.1972, lindur ne Diber dhe banues ne Tirane ne adresen, Rruga “5 Maji”, banese private, shtetesi dhe kombesi shqiptare, arsimi i mesem, i martuar, i pa denuar, me mase sigurimi “arrest ne burg”, ne mungese, i perfaqesuar me deklarim nga Av.Roland Islami.

Akuzuar: Për kryerjen e veprave penale:

1. “Mbajtja pa leje e armës dhe e municionit lufatarak”, parashikuar nga neni 278/2/3 i K.Penal.
2. “Prishja e rendit dhe e qetesise publike”, parashikuar nga neni 274 i K.Penal.
3. “Mbajtja pa leje e armës se ftohte”, parashikuar nga neni 279 i K.Penal.

Në konkluzionet përfundimtare prokurori kërkoi :

- Deklarimin fajtor të pandehurit Xherxh Laci, për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje të armës luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2/3 të K.Penal, dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Xherxh Laçi, për kryerjen e veprës penale të “Prishja e rendit dhe qetesise publike”, parashikuar nga neni 274 i K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashte) muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Xherxh Laçi, për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje e armës se ftohte”, parashikuar nga neni 279 i K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashte) muaj burgim.
- Ne zbatim te nenit 55 te K.Penal, te pandehurit Xherxh Laçi, t'i caktohet nje denim i vetem me 4 (kater) vjet burgim.
- Prova materiale te sekuestruar të kalojë në favor të shtetit.
- Shpenzimet proceduriale ne ngarkim te pandehurit.

-Perfaqesuesi i te pandehurit,kerkoi denimin e te pandehurit Xherxh Laçi me kohen e paraburgimit.

- I pandehuri ne mungese.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VEREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka paraqitur per gjykim çeshtje penale ndaj te pandehurit Xherxh Laçi, i akuzuar per kryerjen e veprave penale “Mbajtja pa leje e armes dhe e municionit lufatarak”, parashikuar nga neni 278/2/3 i K.Penal, “Prishja e rendit dhe e qetesise publike”, parashikuar nga neni 274 i K.Penal dhe “Mbajtja pa leje e armes se ftohte”, parashikuar nga neni 279 i K.Penal.

Nga gjykimi i shkurtuar i çështjes, e cila eshte ne juridiksionin dhe kompetencen e kesaj Gjykate, ka rezultuar e provuar se :

Ne daten 10.01.2013, nga salla operative e Komisarariatit te Policise Nr. 4 Tirane, eshte njoftuar se ne Rrugen “5 Maji” nje person i pa identifikuar po qellonte me arme ne ajer, ne oborrin e baneses s etij. Nga ana e punonjesve te policise te ketij komisaritati menjehere kane shkuar ne vend ngjarje dhe eshte konstatuar se ne oborrin e shtetasit Xherxh Laçi, kishte gezhoja predhash, ndersa i pandehuri ishte mbyllur ne katin e dyte te baneses. Nga ana e policise eshte bere e mundur arrestimi ne flagance e te pandehurit dhe jane kryer veprimet ne vendin e ngjarjes.

Nga veprimet e kryera nga policia gjyqesore gjate kryerjes se vendit te ngjarjes ne ambjentet e jashte te baneses, jane fiksuar dhe me pas sekuestruar 39 cope gezhoja, ndersa ne ambjentet e brendshme eshte sekuestruar nje automatick i tipit kallazhnikov, te cilin i pandehuri e kishte fshehur poshte krevatit ne dhomen e gjumit, si dhe dy krehera me nga (30 dhe 27 cope seicila fisheke). Gjithashtu ne kete ambient jane sekuestruar nje cope fisheke model 56, 8 cope fisheke luftarak 9 mm, 11 cope fisheke model 54 dhe 3 cope fisheke per arme me tyte te gjate, nje kemishe predhe, si dhe nje thike.

Sipas deklarimeve te shtetasve Nazif Laçi dhe Elvis Laçi, rezulton se jetojne ne nje banese, por me kate te ndryshme me te pandehurin Xherxh Laçi. Ata kane qene ne pazar dhe kur kane degjuar krismat, menjere kane shkuar ne banese, ku kane marre vesh se i pandehuri kishte pire alkool dhe me pas kishte qelluar me arme. Ata kane deklaruar se nuk kane patur dijeni per armen qe i pandehuri e ka patur ne banese.

Sipas Aktit te Ekspertimit teknik dhe balistik Nr. 590 date 17.01.2013, ka rezultuar se :

- “Arma e zjarrit Nr.17066118 eshte arme luftarake model 56 dhe eshte ne gjendje te rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht”.
- 40 cope gezhojat e sekuestruar si prove materiale jane qitur nga e njejta arme zjarri, ajo me Nr.17066118.

Nga Akti i Ekspertimit teknik fishekes me Nr.16 date 30.01.2013, ka rezultuar se :

- “Fisheket e sekuestruar jane te rregullt teknikisht dhe te pershtatshem per te rezlizuar qitje luftarake”.

Nga Akti i Ekspertimit teknik thike me Nr.17 date 28.01.2013, ka rezultuar se:

- *“Thika e sekuestruar dhe e paraqitur per ekspertim, i ploteson kushtet teknike te armeve te ftohta”.*

Ne gjykimin e shkurtuar, i pandehuri Xherxh Laçi i pranoi faktet e paraqitura nga prokurori dhe shprehu pendim te thelle per veprimet e kryera.

Ekzistenca e këtyre fakteve penale dhe fajesia e te pandehurit, veç qendrimit te tij pohues, vërtetohet me :

- Procesverbal i kapjes dhe arrestimit ne flagrance date 09.01.2013.
- Procesverbal i kqyrjes se vendit te ngjarjes, date 09.01.2013.
- Procesverbal i sekuestrimit te provave materiale date 09.01.2013.
- Aktit te Ekspertimit teknik dhe balistik Nr. 590 date 17.01.2013
- Akti i Ekspertimit teknik fishekes me Nr.16 date 30.01.2013
- Akti i Ekspertimit teknik thike me Nr.17 date 28.01.2013
- Procesverbal i deklarimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake të shtetasve Nazif Laçi dhe Elvis Laçi.

Ne keto kushte, Gjykata i gjen te drejta akuzat e ngritura nga prokurori, sepse i pandehuri Xherxh Laçi me veprimet e kundraligjshme te kryera, duke mbajtur pa leje te organeve kompetente nje arme zjarri, nje arme te ftohte dhe nje sasi municioni luftarak, si dhe duke qelluar me arme zjarri disa here ne ajer, ka konsumuar plotesisht elementet e veprave penale “Mbajtja pa leje e armes lufatarake”, “Mbajtja pa leje e municionit luftarak” parashikuar perkatesisht nga paragrafet e dyte dhe te trete te nenit 278 te K.Penal, “Prishja e rendit dhe e qetesise publike”, parashikuar nga neni 274 i K.Penal dhe “Mbajtja pa leje e armes se ftohte”, parashikuar nga neni 279 i K.Penal.

I pandehuri eshte ne moshë madhore, i ka kryer me faj veprat penale dhe eshte i pergjegjshem perpara ligjit per veprat e kryera, prandaj duhet te denohen penalisht.

Ne caktimin e llojit dhe te mases se denimit Gjykata ka parasysh :

Rrezikshmerine relativisht te larte shoqerore te veprave penale te kryera nga i pandehuri Xherxh Laçi, te cilat kane cenuar marredheniet juridike te vendosura per te siguruar, paprekshmerine e jetes dhe te shendetit te individit, ndaj veprimeve kriminale, mbajtjen dhe perdorimin e armeve te zjarrit, ruajtjen e rendit dhe qetesise publike, konform ligjit dhe akteve nen ligjore.

Rrezikshmerine relativisht te larte shoqerore te pandehurit Xherxh Laçi, i cili rezulton i pa denuar, ka shprehur pendim te thelle per veprat e kryera, fakt ky i parashikuar si rrethana lehtesuese, konform nenit 48.ç te K.Penal.

Nisur dhe nga marzhet e denimit per keto vepra penale te kryera nga i pandehuri, Gjykata çmon se te pandehurit duhet t'i caktohen keto masa denimi :

- 1 (nje) vit burgim, per kryerjen e vperes penale “Mbajtja pa leje e armes lufatarake”, parashikuar nga neni 278.2 i K.Penal.
- 6 (gjashte) muaj burgim, per kryerjen e vperes penale “Mbajtja pa leje e municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278/3 i K.Penal.
- 6 (gjashte) muaj burgim, per kryerjen e vperes penale “Prishja e qetesise publike”, parashikuar nga neni 274 i K.Penal.

- 6 (gjashte) muaj burgim, per kryerjen e vperes penale “Mbajtja pa leje e armes se ftohte”, parashikuar nga neni 279 i K.Penal.

Ne zbatim te nenit 55.1 te K.Penal, te pandehurit Xherxh Laçi, duhet t'i caktohet nje denim i vetem me 2 (dy) vjet e 6 (gjashte) muaj burgim.

Mbi kete mase denimi duhen zbatuar kerkesat e nenit 406.1 te K.Pr.Penale, per shkak te zhvillimit te gjykimit te shkurtuar, duke i ulur te pandehurit 1/3 e denimit, te cilit i mbetet per te vuajtur 1 (nje) vit e 8 (tete) muaj burgim.

Gjykata në zbatim të nenit 190.1/b të K.Pr.Penale, çmon se provat materiale te evidentuara me Proçesverbalin “Per sekuestrimin e provave materiale” te dates 09.01.2013, si me poshte:

- Nje arme zjarri Kallazhnikov, model 56 me 2(dy) karikator.
- Nje fisheke model 56 ; 3 cope fisheke per arme me tyte te gjate ; 8 cope fisheke te kalibrit 9 mm ; 11 (njembehjete) cope fisheke model 54; 1 (nje) pale dylbi, duhet të kalojne ne inventarin e Ministrise se Brendshme.

Persa i perket proves materiale, nje thike me bisht druri me ngjyre kafe, se bashku me kellefin, ne zbatim te nenit 190.1/b te K.Pr.Penale, duhet te azgjesohet.

Per shkak se i pandehuri rezultoi fajtor per veprat penale per te cilat akuzohet, bazuar ne nenet 393, 485 te K.Pr.Penale, ai duhet te ngarkohet me pagimin e shpenzimeve proceduriale.

PER KETO ARSYE

Gjykata në zbatim dhe të neneve 379 - 384, 390 të K.Pr.Penale.

VENDOSI

- Deklarimin fajtor te pandehurit **Xherxh Nazif Laçi**, per kryerjen e vepres penale “Mbajtja pa leje e armes luftarake”, bazuar ne nenin 278.2 te K.Penal, dënimin me 1 (nje) vit burgim.
- 2. Deklarimin fajtor të pandehurit **Xherxh Laçi**, për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje e municionit luftarak”, bazuar ne nenin 278/3 te K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashte) muaj burgim.
- 3. Deklarimin fajtor të pandehurit **Xherxh Laçi**, për kryerjen e veprës penale “Prishja e qetesise publike”, bazuar ne nenin 274 i K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashte) muaj burgim.
- 4. Deklarimin fajtor te pandehurit **Xherxh Laçi**, per kryerjen e vepres penale “Mbajtja pa leje e armes se ftohte”, bazuar ne nenin 279 te K.Penal, dënimin me 6 (gjashte) muaj burgim.
- Bazuar ne nenin 55.1 te K.Penal, te pandehurit **Xherxh Laçi**, i caktohet nje denim i vetem me 2 (dy) vjet e 6 (gjashte) muaj burgim.

- Në zbatim të nenit 406.1 të K.Pr.Penale,të pandehurit Xherxh Laçi, i ulet 1/3 e dënimit dhe i mbetet për të vuajtur 1 (nje) vit e 8 (tete) muaj burgim.
- Vuajtja e dënimit për të pandehurin të filloi nga dita e arrestimit në flagrance , date 09.01.2013.
- Provat materiale të evidentuara me Proçesverbalin “Për sekuestrimin e provave materiale” të datës 09.01.2013, si më poshtë:
 - Një armë zjarri Kallazhnikov, model 56 me 2(dy) karikatore.
 - Një fisheke model 56 ; 3 cope fisheke për armë me tytë të gjatë ; 8 cope fisheke të kalibrit 9 mm ; 11 (njembëdhjetë) cope fisheke model 54; 1 (nje) pale dylbi, të kalojë në inventarin e Ministrisë së Brendshme.
 - Një thikë me bisht druri me ngjyrë kafe, së bashku me kellefin, të azgjeshohen.
 - Shpenzimet proceduriale i ngarkohen të pandehurit.
- Kunder këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 ditësh nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- U shpall në Tiranë, më datë 08.05.2013.

SEKRETARE
MARJANA XHAMALLATI

GJYQTAR
ALTIN ABDIU